

URDHËR
Nr. 203, datë 18.11.2025

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCËS PËR NËNSHKRIMIN E “CERTIFIKATËS
PARAPRAKE” DHE “CERTIFIKATËS” TË SUBJEKTEVE QË USHTROJNË
VEPRIMTARINË E AGROTURIZMIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe të shkronjës “dh”, të pikës 1, të nenit 17, të urdhrit të përbashkët të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 15 datë 15.1.2024, “Për miratimin e rregullores mbi funksionimin e komisionit vlerësues të certifikimit të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e agroturizmit, procedurat e aplikimit, të vlerësimit paraparak dhe përfundimtar, si dhe pezullimi dhe/ose shfuqizimi i certifikatës paraprake apo i certifikatës”

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës për nënshkrimin e “Certifikatës paraprake” dhe “Certifikatës” të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e agroturizmit të miratuara nga Komisioni Vlerësues i Certifikimit të Subjekteve që Ushtrojnë Veprimtarinë e Agroturizmit, te znj. Llambriola Misto, Sekretar i Përgjithshëm.
2. Ngarkohet znj. Llambriola Misto, Sekretar i Përgjithshëm, për zbatimin e këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS
DHE SPORTIT**
Blendi Gonxhja